



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 635, Datë 16.12.2020

PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL PËR
PERIUDHËN E VLERËSIMIT 2017-2019, PËR GJYQTAREN {...}, E CILA KA
PLOTËSUAR KRITERET LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJE NË DETYRË
NË GJYKATËN E APELIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 61, pika 1, nenin 63 dhe nenin 86, shkronja “dh”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 22.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, nr. 276 dt. 10.12.2019 “Për miratimin e programit të vlerësimeve etik dhe profesional për vitin 2020”, nr.70 datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, pas verifikimit të kriterëve të kandidimit për gjyqtaren {...}, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe mbas shortit të realizuar,

VENDOSI:

- I. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtaren {...}, e cila ka plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit.
- II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, si më poshtë:
 1. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR